




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/OPK	Nr. Prot. B: Prot. 01-124/14
Nr. f. lag. 02	Data Datum 15-01-2014
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4405/13, për z. Genc Prelvukaj – Këshilltar politik i Ministrisë të kulturës, rinisë dhe sportit (MKRS), për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4405-13, për Zyrtarin e lartë, z. Genc Prelvukaj – Këshilltar politik i Ministrisë të kulturës, rinisë dhe sportit (MKRS) dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-4405/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit të lartë, z. Prelvukaj së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me plotësimet që duhet të bëjë, për të saktësuar kush është personi i autorizuar i biznesit privat, për të parandaluar kështu situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Prelvukaj është deklaruar se menjëherë do t'i bëjë këto ndryshim-plotësime në biznesin e tij, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pak ditë pas këtij takimi, z. Prelvukaj në AKK ka sjell edhe shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-36/14) në të cilin shihet se biznesi privat "Gramafoni" tashmë ka një person të autorizuar, ndërsa ztr. Prelvukaj ushtron vetëm të drejtën pasive të bashkëpronësisë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

